



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 527/3 prot.

Tiranë, më 18.11.2020

VENDIM
Nr.150, datë 18.11.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 92, DATË 14.11.2018

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 92, datë 14.11.2018, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Instituti i Transportit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”,

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 60, datë 7.6.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Instituti i Transportit”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin Instituti i Transportit.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin Paralajmërues nr. 92, datë 14.11.2018, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Instituti i Transportit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Instituti i Transportit, me shkresën nr. 85/1 prot., datë 19.6.2020, “Mbi zbatimin e rekomandimeve të KMSHC”, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues dhe në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Instituti i Transportit, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim. Konkretisht:

1. Departamenti i Administratës Publike ka kryer procedurat e konkurrimit dhe, në përfundim të procesit, ***** është emëruar nëpunëse civile në pozicionin “Drejtor” i Institutit të Transportit, me aktin nr. 31 prot., datë 04.01.2019.
2. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe Departamenti i Administratës Publike janë duke punuar për përmbylljen e procesit të hartimit e më pas miratimit të përshkimeve të punës.
3. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, ka plotësuar dosjen e personelit me kërkesën me shkrim për dorëheqje për rastin e nëpunëses *****.
4. Janë marrë të gjitha masat duke plotësuar mangësitë e konstatuara në aneksin nr. 2 të Raportit Përfundimtar të mbikëqyrjes, aktet në mungesë janë bërë pjesë të dosjes individuale të personelit.
5. Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 508 prot., datë 24.01.2020, ka vendosur emërimin e nëpunëses ***** në pozicionin “Specialist” në Sektorin e Planifikimit të Transportit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 92, datë 14.11.2018, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Instituti i Transportit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Instituti i Transportit, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 92, datë 14.11.2018.

3. Për këtë vendim të njoftohet Instituti i Transportit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Departamenti i Administratës Publike.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha